00	05100	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	1,171	1,171
Menaxhimi i Mbetjeve				SHUMA 05100			7,003	42,863	49,866
00	6140	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	230	0	617	617
00	6140	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	682	2,084	2,766
Strehimi Social				SHUMA 06140			682	2,701	3,383
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	2,889	2,172	5,061
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	619	302	921
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	2,839	3,449	6,288
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	604	465	14	479
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	606	0	27	27
00	06260	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	230	0	1,709	1,709
00	06260	06	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	3,500	22,640	26,140
Shërbimet Publike				SHUMA 06260			10,312	30,313	40,625
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	0	4,216	4,216
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	0	697	697
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	0	3,034	3,034
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	603	0	0	0
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	604	1,913	5,760	7,673
00	06370	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	1,500	1,500
Ujesjellesi				SHUMA 06370			1,913	15,207	17,120
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	0	20	20
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	0	498	498
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	230	0	20	20
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	763	15,945	16,708
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	4662104	(170)	(117)	(287)
00	07220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	4662114	0	0	0
Sherbimet e Kujdesit Parësor				SHUMA 07220			593	16,367	16,960
00	08130	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	0	24	24

00	08130	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	0	140	140
00	08130	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	0	5,177	5,177
00	08130	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	604	0	1,616	1,616
00	08130	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	3,069	3,069
Sport dhe Argëtim				**SHUMA 08130**			**0**	**10,026**	**10,026**
00	08220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	146	558	704
00	08220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	24	92	116
00	08220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	1,263	5,848	7,111
00	08220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	230	0	100	100
00	08220	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	14,050	14,050
Trashëgimia Kulturore				**SHUMA 08220**			**1,433**	**20,649**	**22,082**
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	9,732	4,986	14,718
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	1,670	1,809	3,479
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	8,174	20,011	28,185
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	604	0	0	0
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	606	10	0	10
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	230	0	628	628
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	5,143	76,572	81,715
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	4662104	0	0	0
00	09120	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	4662114	0	0	0
Arsimi Parashkollor				**SHUMA 09120**			**24,730**	**104,006**	**128,736**
00	9230	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	3,426	236	3,662
00	9230	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	612	47	659
00	9230	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	2,537	6,555	9,092
00	9230	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	606	20	0	20
00	9230	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	16,302	16,302
Arsimi Parauniversitar				**SHUMA 9230**			**6,595**	**23,140**	**29,735**
00	10430	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	2,927	8,110	11,037
00	10430	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	500	1,361	1,861
00	10430	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	14,086	4,798	18,884
00	10430	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	606	70	0	70
00	10430	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	25	2,480	2,505
Qendra Sociale				**SHUMA 10430**			**17,608**	**16,749**	**34,357**
00	10661	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	600	0	900	900

00	10661	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	601	0	100	100
00	10661	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	602	1,243	0	1,243
00	10661	01/05	2157001	Bashkia Vau-Dejes	3333	231	0	5,000	5,000
Strehimi Social				**SHUMA 10661**			**1,243**	**6,000**	**7,243**
Total Fonde te Trasheguara							**195,659**	**701,503**	**897,162**

Verdhë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(C2) DETYRIMET E PRAPAMBETURA

		2023	2023		2024		2025		2026		
		Viti aktual	Viti aktual		Viti t+1 (I pritur)		Viti t+2 (I pritur)		Viti t+3 (I pritur)		
Kreditor	Data e Detyrimit	Stoku i borxhit, 31 Tetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	Amortizimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit	Stoku i borxhit, 31 Dhjetor	
MANDI 1	19.02.2018	3,870,553	0	3,870,553	3,870,553	0		0		0	OK!
Vendim Gjyqesor	12.10.2018	1,230,000	0	1,230,000		1,230,000		1,230,000	1,230,000	0	OK!
Vendim Gjyqesor	30.05.2013	2,112,860	0	2,112,860		2,112,860		2,112,860	2,112,860	0	OK!
PALMA Construction	31.12.2020	19,800	0	19,800	19,800	0		0		0	OK!
Alko Impex General Construction Shpk	18.02.2021	267,642	0	267,642	267,642	0		0		0	OK!
PALMA Construction	21.04.2021	9,000	0	9,000	9,000	0		0		0	OK!
Dion-Al Shpk	29.10.2021	10,976,626	0	10,976,626	10,976,626	0		0		0	OK!
Lodi Construction Shpk	17.03.2022	92,477	0	92,477	92,477	0		0		0	OK!
Dion-Al Shpk	30.12.2022	42,424,558	0	42,424,558	42,424,558	0		0		0	OK!
Xhet Shpk	24.08.2023	3,831,384	3,831,384	0		0		0		0	OK!
Bersant Ylli PF	22.09.2023	170,976	170,976	0		0		0		0	OK!
Bersant Ylli PF	22.09.2023	186,289	186,289	0		0		0		0	OK!
Bersant Ylli PF	22.09.2023	124,193	124,193	0		0		0		0	OK!
Bersant Ylli PF	22.09.2023	263,020	263,020	0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
				0		0		0		0	OK!
Total		65,579,378	4,575,862	61,003,516	57,660,656	3,342,860	0	3,342,860	3,342,860	0	

Copyright for Albania: Ministry of Finance and Economy / Local Finance Directory

RELACION

Mbi parashkimin e te ardhurave per PBA 2024-2026

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Vau-dejes.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:
1.Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", te ndryshuar;
2.Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar;
3.Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
4. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vau dejes, nr 71 date 26.11.2020 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau dejes", të ndryshuar

Planifikimi i te ardhurave nga taksat&tarifat është mbeshtetur ne disa faktor, llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet,kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, te cilat jane te percaktuara ne dokumentin "Pakete Fiskale", e cila përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.
Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.
Paketa fiskale e Bashkisë Vau dejes për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

<u>Politikat incentivuese në taksa:</u>
• *Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri ne 30% nga referenca ligjore, per zonat malore.*

• *Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.*
• *Nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukture dhe uljet nën nivelet e kostos së sherbimit të llogaritur:*
<u>Politikat incentivuese në tarifa:</u>
• *Tarifa te reduktuara deri ne 50% për invalidet, verberit*

• *Kryefamiljaret femra qe trajtohen me ndihme ekonomike.*
• *Gra krefamiljare viktima te dhunes ne familje apo objekt trafikimi.*
•*Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore*
• *Tarifa 0(zero)subjektet qe perfitojne projekte nga Zyra e Punes(START-UP)ne vitin e pare.*


Bashkia Vau dejes, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksa paguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.
Bashkia Vau dejes, ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Të ardhurat e veta të Bashkisë te kategorizuar sipas llojit te te ardhurave, për periudhen 2024-2026, parashikohen ne vlerat si me poshte


ne (000/leke)

Vitet	2024	2025	2026
Ardhurat e veta totale	**173,816**	**176,186**	**177,000**
Ardhura nga taksat vendore	**49,794**	**50,041**	**50,306**
Ardhura nga taksat e ndara	**29,539**	**29,843**	**29,948**
Ardhura nga tarifat vendore	**66,988**	**67,532**	**68,856**
Ardhura te tjera	**27,495**	**28,770**	**27,890**

Pesha e cdo takse e tarife ne parashikimin e te ardhurave



Të Ardhurat e Bashkisë (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit) per 3 vitet e para buxhetore dhe 3 vitet e ardhshme buxhetore paraqiten si ne grafikun e meposhtem:



Të ardhurat e veta, që mblidhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2024-2026 parashikohen që të kenë një trend të njëjtë për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave qe ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2024-2026 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 23 %, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 4 %, tarifa për pastrimin zë rreth 22 %, taksa e qarkullimit tëmjeteve të përdorura zë rreth 11 %, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 7 %, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rreth 16 %. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 83 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Vau dejes.

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2024-2026 i kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor paraqitet si më poshtë:

LLOJET E TË ARDHURAVE	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakti 2022	I pritshmi 2023	2024	2025	2026
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	**85,427**	**90,971**	**127,605**	**170,018**	**173,817**	**176,186**	**177,000**
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	**42,942**	**53,531**	**55,406**	**91,642**	**79,333**	**79,884**	**80,254**
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	1,264	645	146	-	-	-	-
2% tatimi mbi te ardhurat personale	0	8,822	**9,984**	**8,796**	**10,000**	**10,300**	**10,403**
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	**20,797**	**23,183**	**20,812**	**47,994**	**40,191**	**40,438**	**40,687**
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	9,436	**11,172**	**10,125**	**20,266**	**18,806**	**18,994**	**19,184**
Ndërtesa banimi	-	4,008	3,546	*12,266*	*9,165*	*9,257*	**9,350**
Ndërtesa të tjera	-	7,164	6,580	*8,000*	*9,640*	*9,737*	**9,834**
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	6,505	6,984	**6,066**	**22,238**	**15,500**	**15,500**	**15,500**

Taksa mbi truallin	4,855	**5,028**	**4,621**	**5,490**	**5,885**	**5,944**	**6,003**
Të ardhura nga taksa mbi truallin familje	0	121	92	*280*	*218*	*220*	**222**
Të ardhura nga taksa mbi truallin biznes	0	4,907	4,529	*5,210*	*5,667*	*5,724*	**5,781**
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	75	58	**4**	**100**	**103**	**103**	**104**
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	5,850	3,189	**5,655**	**11,952**	**8,000**	**8,000**	**8,000**
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	234	-	**1,089**	**300**	**100**	**100**	**100**
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	13,476	16,115	**16,599**	**20,000**	**19,289**	**19,289**	**19,289**
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	0	272	**102**	**350**	**100**	**103**	**104**
Të ardhura nga taksa e akteve të pullë	78	113	**60**	**150**	**50**	**52**	**52**
Të ardhura nga taksa e tabelës&reklame	1,170	1,134	**956**	**2,000**	**1,500**	**1,500**	**1,515**
Të ARDHURAT JOTATIMORE	**42,485**	**37,440**	**72,199**	**78,376**	**94,484**	**96,302**	**96,746**
Të ardhurat nga Tarifat vendore	**27,297**	**30,688**	**28,743**	**59,906**	**66,989**	**67,532**	**68,856**
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	19,001	**21,723**	**19,165**	**32,825**	**37,972**	**38,351**	**38,357**
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	-	6,221	*5,210*	*12,635*	*17,440*	*17,615*	**17,615**
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	-	493	*493*	*500*	*515*	*520*	**525**
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	-	15,008	*13,462*	*19,689*	*20,017*	*20,217*	**20,217**
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	2,725	**3,684**	**3,589**	**7,114**	**12,808**	**12,935**	**12,977**
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	-	1,938	*1,727*	*4,928*	*8,585*	*8,671*	**8,671**
Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	-	28	*28*	*136*	*136*	*136*	**137**
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	-	1,718	*1,834*	*2,050*	*4,087*	*4,128*	**4,169**
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	2,270	**2,678**	**2,530**	**3,889**	**4,092**	**4,114**	**4,137**
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	-	804	*654*	*1,643*	*1,781*	*1,781*	**1,781**
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	-	28	*28*	*136*	*136*	*136*	**137**
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	-	1,846	*1,847*	*2,110*	*2,175*	*2,197*	**2,219**
Tarife e mirembajtjes se infrastruktures se ujitje-kullim	**0**	**911**	***1,057***	**4,151**	**2,906**	**2,906**	**4,151**
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	**3,300**	**1,692**	**2,402**	**11,927**	**9,211**	**9,226**	**9,233**
Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	782	197	*178*	*300*	*200*	*206*	**208**


Nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura	703	766	-	-	-	-	-
Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	139	**89**	*208*	*300*	*150*	*155*	**156**
Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike	256	**305**	*523*	*400*	*350*	*361*	**364**
Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	1,000	-	*1,300*	*10,000*	*8,000*	*8,000*	**8,000**
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	**256**	**144**	*22*	*397*	*181*	*175*	**173**
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	**157**	**191**	*167*	*300*	*200*	*200*	**202**
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	-	-	*4*	*30*	*30*	*30*	**30**
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	7	-	-	*200*	*100*	*100*	**100**
TË ARDHURA TË TJERA	**15,189**	**6,752**	**43,456**	**18,470**	**27,495**	**28,770**	**27,890**
Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)	**2,026**	**1,100**	*2,165*	*2,650*	*2,450*	*2,450*	**2,450**
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (ndertese)	116	789	*783*	*738*	*738*	*745*	**753**
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (truall)	**318**	531	*170*	*105*	*5*	*5*	**5**
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (toke bujqesore)	4,930	1,289	*700*	*1,035*	*711*	*732*	**739**
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota)	978	2,886	*9,593*	*13,783*	*21,831*	*21,831*	**21,831**
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	0	0	-	*50*	*5*	*5*	**5**
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	-	-	-	*50*	*5*	*5*	**5**
Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	*50*	*5*	*5*	**5**
Të ardhura nga shitja dok. tenderi	14	6	*12*	*10*	*5*	*5*	**5**
Te ardhura te tjera jotatimore	7	150	*33.89*	-	*5*	*5*	**5**
Të ardhura nga sponsorizimet	6,800	-	*30000*	-	1,736	2,982	**2,087**

Tabela e meposhteme pasqyron te ardhurat sipas njesive administrative:

VITI	TOTALI	NJ.A VAUDEJES	NJ.A BUSHAT	NJ.A HAJMEL	NJ.A VIG-MNELE	NJ.A SHLLAK	NJ.A TEMAL
VITI 2024	**173,817**	59,099	88,648	17,382	3,477	1,738	3,473
VITI 2025	**176,186**	59,904	89,854	17,619	3,524	1,762	3,523
VITI 2026	**177,000**	60,180	90,270	17,700	3,540	1,770	3,540

Peshen kryesore ne bazen e taksueshme te te ardhurave te planifikuara, e ze Njesia Administrative Bushat me afro 50% te planit dhe Njesise Administrative Vau-dejes,me rreth 38%

ndersa njesite e tjera kane nje peshe specifike te vogel, kjo si rrjedhoje e numrit te madh te popullsise dhe numrit te biznesve, ne keto dy njesi.



A. Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.
Per vitet 2024-206 parashikohet qe te ardhurat nga taksat vendore te perbejne rreth 29% te totalit te te ardhurave nga burimet e veta te Bashkise.

A.1. Te Ardhura nga Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :
- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin (familje, biznes)

Parashikimi për vitet 2024-2026 ka nje rritje te lehte, nga viti ne vit, ku bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- *Percaktimit te sakte te kryefamiljareve sipas rregjistrit te gjendjes civile.*
- *Mbështetja nga agjentë tatimorë,*
- *Rritja pak a shume e nr. bizneseve active, duke formalizuar aktivitetet e tyre.*
- *Rritja e nr. te siperfaqeve te ndertesave nga ndertimet e reja.*
- *Rritja e nr. te formalizimit te pronave, nepermjet certifikatave te pronesise dhe lejeve te legalizimit.*
- *Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI,*

- *Krijimi dhe implementimi i programit te taksave vendore, i cili ka ndikuar ne permiresimin e cilesise saktesise se te dhenave si dhe ne zgjerimin e bazes se taksapaguesve, dhe shpejtesise per kryejen e sherbimit,gjithashtu ndikon ne uljen e evazionit fiskal.*

Taksa mbi pasurine e paluajtshme ze peshen te madhe rreth 29% te te ardhurave te planifikuara nga taksat vendore, dhe paraqitet ne tabelen e meposhte:

Ne 000/leke

Emertimi/Vitet	2024	2025	2026
Taksa mbi pasurine paluajtshme	40,191	40,439	40,687
Taksa e nderteses	18,806	18,994	19,184
Taksa e truallit	5,885	5,944	6,003
Taksa mbi token bujqesore	15,500	15,500	15,500

A.2. Taksa e fjetjes ne hotel.

Kjo takse eshte parashikuar nje rritje e vogel prej 3%, jo me shume per arsye te ndryshimit te jetes sociale per shkak te pandemise, si dhe zvogelimit te nr.te shtreterve dhe numrit te vizitoreve ne vendin tone, por kemi ruajtur kete rritje ne vitet e ardhshme, me shpresen e hapjes dhe ardhjes se vizitoreve vendas dhe te huaj.

	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa e fjetjes në hotel	100	103	104

A.3. Taksa e tabeles.

Ne fakt kjo takse per shkak vleres se madhe nga percaktimet ligjore, qe duhet te paguajne subjektet private, kane bere zvogelimin e siperfaqes te tabelave apo reklamave te tyre dhe si rrjedhoje, e ketij indikatori, nuk kena parashikuar rritje, per arsye edhe te mosrealizimit te te ardhurave nga kjo takse.

	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa e tabelës	**1,500**	**1,500**	**1,515**

A.4. Taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture, eshte parashikuarme zbritje, per arsye te pakesimit te dhenies se lejeve te legalizimit, si dhe duke u bazuar ne realizimet e viteve te meparshme.

	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026

Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	8000	8000	8000

B. Tarifat Vendore


Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:
a) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;b) Tarifa per ndricimin, C) Tarifa per gjelberimin, e) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

B.1. Tarifa per sherbimet publike (pastrim, ndricim, gjelberim, mirembajtje ujitje kullim, sherbim administrativ)

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Për vitin 2024-2026 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 38 % të të ardhurave të veta.
Pjesën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbeturinave me 56 %, gjelbërimi me 6%, ndriçimi publik me afro 19%, etj.

Vitet	2024	2025	2026
Te ardhura nga tarifa e pastrimit	37,972	38,351	38,357
Te ardhura nga tarifa ndricimit	12,808	12,935	12,977
Te ardhura nga tarifa gjelberimit	4,092	4,114	4,137
Te ardhura nga tarifa mirembajte ujitje kullim	2,906	2,906	4,151
Te ardhura nga sherbimi administrativ	9211	9226	9233

Raporti i tarifave vendore, mbi totalin e te ardhurave te veta
Paraqitet ne grafikun e meposhtem



Parashikimi i të ardhurave nga tarifat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, etj bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive taksapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si

dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit te shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative.Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e rregjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.
Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 15.000 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 90%.
Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)

Nr	Bashkia Vau dejes	Familje	Biznese
1	Njësia Administrative Vau dejes	**4403**	**212**
2	Njesia Administrative Bushat	6764	379
3	Njesia Administrative Hajmel	2139	37
4	Njesia Administrative Vig-Mnele	852	4
5	Njesia Administrative Temal	817	15
6	Njesia Administrative Shllak	690	3
	TOTALI	**15665**	**650**

Taksapaguesit familjarë

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kryefamiljeve rezidente sipasrregjistrit gjendjes civile.
Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Vau dejes është 15665. Në paketën fiskale të Bashkisë Vau dejes janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në rreth 14.631 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj.


Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale te bashkisë Vau dejes është 658. Biznesi i vogël zë rreth 80% të numrit total të bizneseve.
Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:


KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Vau-Dejes	Totali	Biznesi vogel	Biznesi madh	Institucione
1	Nj.A qender Vau-dejes	212	175	35	2
2	Nj.A Bushat	379	299	80	0
3	Nj.A Hajmel	37	33	4	0
4	Nj.A.Vig-Mnele	4	4	0	0
5	Nj.A.Shllak	3	1	2	0
6	Nj.A Temal	15	15	0	0
	TOTAL	**650**	**527**	**121**	**2**

Shperndarja e biznesit ne Bashkine Vau dejes




Raporti i biznesve sipas xhiros



Ne tabele vihet re se peshen me te madhe e ze biznesi I vogel, dhe sidomos ai me aktivitet tregti e sherbime

Kapaciteti i bizneseve sipas natyres dhe madhesise

Nr.	Sektori	Biz.Madh	Biz.Mesem	Bis. Vogel	gjithsejt
1	Sherbimeve	30	2	270	**302**
2	Prodhim	16	2	56	**74**
3	Tregti	59	4	150	**213**
4	Transport	4	0	27	**31**
5	Ndertimi	8	1	8	**17**
6	Turizmi	2	0	9	**11**
7	Institucion	2	0	0	**2**
	Totali	**121**	**9**	**520**	**650**



Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdishëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eleminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Për realizimin e të ardhuravetë veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar stategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

a) Identifikimi i objektivave
b) Identifikimi i risqeve te jashtme dhe të brendshme.
c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjës së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.
g) Monitorimi dhe raportimi.
h) Hartimi i planit te veprimit.

Regjistri i Riskut

Nr	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrolli t	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrollev e ekzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar =)
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm-ulët	Monitorime në terren nga inspektoret e zonës	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit të punës për evidentim	Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Agjencia Shteterore e Kadastres	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për infomracion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Agjencia Shteterore e Kadastres	Agjencia e Shteterore e Kadastres	Pandryshuar
3	Mungesa infomracionit nga QKB-ja	ulët-ulët	Kërkesa shkresore për infomracion	ulët-ulët	po	Bashkepunim me QKB-ne	QKR dhe Sektori i Regjistrimit	Përmirësuar
5	Mungesa e infomracionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime ne terren nga Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara pët evdientimin e taksapaguesve	Njësitë Administrativ e dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
6	Mungesë infomracioni për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - i ulët	po	Bashkepunim me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori Familjar	Pandryshuar
8	Dokumenaci on bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	mesëm - ulët	Po	Pasurimi gjatë dhenies së sherbimit ndaj taksapaguesit	Zyra me një ndalesë dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
9	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatija e planveprimit	Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Pandryshuar

10	Rakordim i shpejtë i pagesave	ulët - ulët	Marrja ne kohe e arketimeve me banke nga Dega e Thesarit	mesem	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
12	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	mesem	Analiza mujore sipas zërave	mesem	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecurisë	Sektori i taksave dhe tarifave vendore	Përmirësuar
13	Realizimi i të ardhurave nga familjet	ulet-ulët	Analiza sipas Njësive Administrative	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i sipas ecurisë	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
14	Realizimi i të ardhurave nga agjentë tatimorë	mesëm - ulët	Analiza mujore	ulët-ulët	po	Analizë për çdo agjent	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
16	Azhornimi i vazhdueshem i programit të taksave	ulët-ulët	Bashkëpunim me programuesit për azhornimin e te dhenave ne program.	ulët-ulët	po	Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore dhe sektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Përmirësuar
17	Dhënia e informacionit për taksapaguesit	ulët-ulët	Dhënie e shërbimit pranë sportleve	mesem	jo	Kkoha e dhenies pergjigje kerkesave te taksapaguesve	Zyra me Një ndalesëDrejtoria Ekonomike	Përmirësuar
18	Llogaritje e shpejtë e detyrimeve	ulët-ulët	Përfshirje e llogartjes së detyrimit në program taksash	mesem	po	Plotesimi i kerkesave të taksapaguesve	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
19	Evidentim i shpejtë i pagesave	mesëm-ulët	Kontabilizim i shpejtë i të ardhurave	mesem	jo	Monitorimi i kohës për emetimin e evidencave	Sektori i Taksave dhe tarfiave vendore	Përmirësuar
21	Përditësim me standartet e reja ligjore	ulët- ulët	Shyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve	ulët- ulët	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	Drejtoria Ekonomike	Pandryshuar
22	Njohuri mbi sistemet on-line të instaluara	ulët- ulët	Shqyrtimi dhe krahasimi mes nevojave dhe programeve	ulët- ulët	po	Perditesime periodike mbi nevojën për zgjerim te njohurive	Drejtoria Ekonomike	Pandryshuar
23	Njohje me eksperienca të ngjashme dhe trainime profesionale	mesëm-ulët	Trainime dhe dikustime mbi to	ulët- ulët	po	Diskutime dhe konstatime	Drejtoria Ekonomike	Përmirësuar

Relacion

Për miratimin e shpenzimeve te Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetin e vitit 2024 per Bashkine Vau Dejës

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve te PBA për Vitet 2024-2026

Percaktimi i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA për vitet 2024-2026,është realizuar bazuar në nenin 9 , 34 dhe 41 te ligjit Nr.139/2015"*Për vetëqeverisjen vendore*",i ndryshuar,te ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", te ndryshuar , nenin 37 te ligjit 68/2017 date 27.4.2017 " *Per financat e veteqeverisjes vendore* ",udhezimit tëMinistrise se Financave dhe Ekonomisënr. 23 date 30.07.2018 " *Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NjQV*", Udhezim nr. 6, date 28.02.2023 "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026" dhe shtojcat plotesuese;
Udhëzimi Plotësues nr. 21 , date 07.07.2023 "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026" dhe shtojcat plotesuese ;
Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 20079 datë 03.11.2023 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2024".

2.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e kushtezuar

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e kushtezuar për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Udhezimi nr 6 date 28.02.2023 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026", dhe Udhëzimit Plotësues nr. 21 date 07.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026", si dhe nëpërmjet shkresës se Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr 20079 datë 03.11.2023 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2024"

Transferta e pakushtwzuar, transferta e pakushtwzuar sektoriale dhe transferta e kushtwzuar pwr vitet 2024-2026 paraqitet nw tabelat mw poshtë:

Transferta e pakushtëzuar

Transferta e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV). Si rregull i përgjithshëm, transferta e pakushtëzuar ka për qëllim t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i tranfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë. Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet.

Transferta e pakushtëzuar për një vitin 2024 është në vlerën 299,147 mijë lekë dhe fondi për rritjen e pagave është në vlerën 21,224 mijë lekë, në total Transferta e pakushtëzuar është e barabartë me shumën 320,371 mijë lekë, përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës së shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë.
Sipas udhëzimi nr 6 date 28.02.2023 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026" tansferta e pakushtëzuar për vitin 2024 ishtë 282,569 mijë lekë, për vitin 2025 ishte 298,886 mijë lekë dhe për vitin 2026 ishte 317,409 mijë lekë. Sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 20079 prot datë 03.11.2023 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2024", transferta e pakushtëzuar për vitin është 299,147 mijë lekë, dhe fondi për rritjen e pagave si transfertë e pakushtëzuar është dërguar në masën prej 21,224 mijë lekë kjo sipas *VKM nr 328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", dhe kjo vlerë është përdorur vetëm në mbështetje të rritjes së pagave për sektorët në bahki. Në total transferta e pakushtëzuar është në vlerën 320,371 mijë lekë, dukë qënë se kjo vlerë e transfertës për vitin 2024 është më e lartë se në udhëzimin nr* 6 date 28.02.2023, ne jëmi bazuar dhe për vitin 2025 dhe 2026 duke ju referuar kësaj vlere *sipas tabelës më poshtë:*

Tabela 1. Transferta e Pakushtëzuar për periudhën 2024-2026

në mijë lekë

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Transferta e Pakushtëzuar	320,371	320,371	320,371

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore". Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".
Funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Tabela 2. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2024-2026

në mijë lekë

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	125,484	125,484	125,484

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për periudhën 2024-2026 ka ardhur sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 20079 prot datë 03.11.2023 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2024", dhe është e detajuaj sipas tabelsës më poshtë:

Tabela 3. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e detajuar për periudhën 2024-2026

në mijë lekë

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	9,350	9,350	9,350
2	Arsimi parashkollor Ndarë me formulë për personelin mësimor	45,721	45,721	45,721
3	Arsimi parashkollor Për stafin mbështetës	1,069	1,069	1,069
4	Arsimi parauniversitar	2,899	2,899	2,899
5	Mbrojtja nga zjarri	15,037	15,037	15,037
6	Mbrojtja sociale	20,363	20,363	20,363
7	Administrimi i pyjeve	7,906	7,906	7,906
8	Rrugët	7,026	7,026	7,026
9	Ujitja dhe Kullimi	13,868	13,868	13,868
10	Menaxhimi i mbetjeve urbane	2,245	2,245	2,245
TOTALI		**125,484**	**125,484**	**125,484**

b) shuma dhe qëllimi i transfertës së kushtëzuar, që Buxheti i Shtetit jep për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Qëllimi i transfertës së kushtëzuar është financimi i shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara është rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës, nga ministritë përkatëse të linjës.

Niveli i transfertës së kushtëzuar është bërë duke u bazuar sipas udhëzimi nr 6 date 28.02.2023 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026", dhe sipas miratimit të tavaneve përgatitore të Bashkisë Vau Dejës". Nga kjo transfertë mbulohen shpenzime për

transferimet individuale për pagesë për personat me aftësi të kufizuar , invaliditeti dhe ndihme ekonomike dhe konkretisht niveli i Transfertës së Kushtëzuar është sipas tabelës më poshtë:

Tabela 4: Transferta e Kushtëzuar për periudhën 2024-2026

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Transferta e Kushtëzuar	378,161	398,161	398,161

Transferta e Totale nga Qeverisja Qendrore

Duke bërë një përmbledhje të tabelave më sipër, total transferta nga qeverisja qendrore për periudhën 2024-2026 janë të detajuara si më poshtë:

Tabela 5: Transfertat Totale nga Qeverisja Qendrore për periudhën 2024-2026

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Transferta e Pakushtëzuar	320,371	320,371	320,371
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	125,484	125,484	125,484
3	Transferta e Kushtëzuar	378,161	398,161	398,161
TOTALI		**824,016**	**844,016**	**844,016**

Buxheti Total i Bashkisë Vau Dejës për periudhën 2024-2026

Bashkia Vau Dejës dukë përfshirë transfertat e qeverisjes qendore (transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale, transferta e kushtëzuar) dhe të ardhurat e planifikuara për periudhën 2024-2026, përbejnë buxhetin total dhe janë të detajuara si më poshtë:

Tabela 6: Buxheti total për periudhën 2024-2026

Nr	Vitet	2024	2025	2026
1	Transferta e Pakushtëzuar	320,371	320,371	320,371
2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	125,484	125,484	125,484
3	Transferta e Kushtëzuar	378,161	398,161	398,161
4	Të Ardhurat	173,816	176,185	177,000
TOTALI		**997,832**	**1,020,201**	**1,021,016**

3.Shpenzimet sipas programeve per vitet 2024-2025-2026

3.1 FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

3.1.1 Nënfunksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; • Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj; • Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; • Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
		• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; • Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
		• Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
		• Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; • Amortizimi i huave të marra etj.

SEKRETARIA BASHKIA VAU-DEJ

Plani i aktivitetit te keshillit bashkiak

Muaji	FUSHA VENDORE
Janar	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.
	Informimi i komunitetit dhe transparenca e Këshillit Bashkiak, llogaridhënia e Këshillit Bashkiak, prezantim i raportit vjetor të punës së Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndesishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.
Shkurt	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në trajnime për sekretariatin e Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Mars	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Miratimi i raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.
	Shqyrtimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesem në nivel programi.
	Vizite studimore në NJQV brenda vendit.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Prill	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhërshme të Këshillit Bashkiak.
	Ndryshim Buxheti.
	Hartim i Planit të Monitorimit të: Shërbimit të pastrimit, Shërbimeve sociale, Arsimit bazë dhe parashkollor, Investimeve publike, etj. Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me keto shërbime, raportim në Këshillë.
